

URDHËR
Nr. 248/4, datë 22.6.2012

PËR DISA SHITESA NË URDHRIN NR. 248, DATË 7.6.2012 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE, PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT ELEKTRONIK “ONE STOP SHOP-SISTEMI I NOTERISË””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,

URDHËROJ:

1. Në tekstin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “One Stop Shop-sistemi i noterisë”, bashkëlidhur urdhrin nr. 248, datë 7.6.2012 të Ministrit të Drejtësisë, bëhen këto ndryshime:

- a) Në nenin 12, shprehja “të këtij neni” zëvendësohet me shprehjen “të nenit 11”.
- b) Pas nenit 12, shtohen nenet 12/1 dhe 12/2, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 12/1

Kërkesë vetëm për informacion të përditësuar të kartelës

Noteri mund të paraqesë pranë ZRPP-së edhe vetëm kërkesë për informacion të përditësuar të kartelës, pa kërkuar leje veprimi të mëtejshme. Në këtë rast, ZRPP-ja jep informacionin e kërkuar, pa rezervuar të drejtën e tjetërsimit për një periudhë prej 30 ditësh kalendarike.

Neni 12/2

Përlllogaritja e tatimit

1. Në paraqitjen e kërkesës për ofrimin e shërbimit, noteri njofton ZRPP-në edhe për vlerën e kontratës, me qëllim përlllogaritjen nga operatori i ZRPP-së të vlerës së tatimit mbi të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë, që do të paguhet nga individ i që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, në llogarinë e noterit.

2. Operatori i ZRPP-së, në momentin që ofron shërbimin e kërkuar nga noteri, për dhënien e informacionit zyrtar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për individët dhe institucionet, e njofton atë edhe për vlerën e tatimit mbi të ardhurat që duhet të paguajë individ i që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, në llogarinë e noterit.

3. Pas lidhjes së kontratës për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme dhe kalimit të vlerës së tatimit mbi të ardhurat në llogarinë e noterit, ky i fundit derdh tatimin në llogarinë bankare të ZRPP-së dhe paraqet dokumentin bankar që konfirmon kryerjen e transaksionit në ZRPP.

4. ZRPP-ja, pasi merr dokumentin bankar që konfirmon kryerjen e transaksionit, vepron në përputhje me udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar, duke bërë dhe kalimin e tatimit mbi të ardhurat për llogari të organeve tatimore.”.

2. Ngarkohen noterët dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri, si dhe njoftimin e tij pranë të gjithë noterëve dhe zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përfshihen brenda fushës së veprimit

të kësaj rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi